



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 380/22
PSH. nr. 389/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga z. Vedat Poterqoi- Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik me datë 23.08.2022 "DWH-Kosova" Sh.p.k me seli në Prishtinë me numër protokollit 380/2022 dhe me datë 26.08.2022 OE "DWH-Albania" Sh.p.k me seli në Tiranë, Shqipëri, me numër protokollit 389/2022 në Organin Shqyrtues të Prokurimit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrument GPS " me nr. të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna Gjakovë, me datën 06.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesa e operatorëve ekonomik "DWH-Kosova" Sh.p.k me seli në Prishtinë dhe OE "DWH-Albania" Sh.p.k me seli në Tiranë, Shqipëri, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrument GPS " me nr. të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna Gjakovë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS " me nr. të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti

Kontraktues– Komuna Gjakovë, të bëj ndryshimet e nevojshme për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “DWH-Kosova” Sh.p.k me seli në Prishtinë dhe OE “DWH–Albania” Sh.p.k, me seli në Tiranë ju aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues: “DWH-Kosova” Sh.p.k me seli në Prishtinë dhe OE “DWH–Albania” Sh.p.k, me seli në Tiranë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 23.08.2022 “DWH-Kosova” Sh.p.k me seli në Prishtinë me numër protokolli 380/2022 dhe me datë 26.08.2022 OE “DWH–Albania” Sh.p.k me seli në Tiranë, Shqipëri, me numër protokolli 389/2022 kanë parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit për aktivitetin e

prokurimit "Furnizim me instrument GPS " me nr. të prokurimit: 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 2, 7 dhe nenin 28 të LPP-së.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore.

Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 12.09.2022, duke sqaruar që:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 – OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke mos dhënë informacion për datasheetet (katalogët) e produkteve të përfshira në këtë aktivitet të prokurimit, të cilat i ka përdorur ose ju është referuar AK për përgatitjen e tenderit.

Ashtu sikurse është sqaruar edhe në Raportin e Ekspertit numër 95-98/21 në lidhje me këtë pretendimin sqarojmë se bazuar në rregullativën për prokurim publik në Kosovë AK-të duhet të përpilojnë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE-të dhe se është e ndaluar që të hartojnë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE. Andaj në këtë kuptim, në asnjë rast AK nuk mund të përdorë një broshurë konkrete të një produkti apo një prodhuesi, përveç në kushte të jashtëzakonshme në raste të veçanta, me kusht që, çfarëdo referimi i të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent". Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar duke marrë parasysh që një kërkesë e tillë nuk bazohet në asnjë dispozitë të legjislacionit për prokurimin publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2 - OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke vendosur kërkesa që favorizojnë vetëm një prodhues, në këtë rast sistemin operativ Windows dhe duke diskriminuar pajisjet që kanë sisteme tjera operative sikurse janë Android dhe iOS.

Ashtu sikurse është sqaruar dhe vendosur në ankesën 458/20, dhe ankesën 95-98/21 kërkesat e tilla në rrethanat të tilla sikurse në këtë aktivitet të prokurimit reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik. Kjo duke marrë parasysh që ekzistojnë në treg kontrollere që operojnë me sistem operativ Android dhe aq më tepër kur kërkesa për sistem operativ nuk limiton në funksionet e AK-së për mbledhjen dhe shkëmbimin apo bartjen e të dhënave në pajisje tjera sikurse mund të jenë kompjuterët e zyrës. AK, fjalën ekuivalente të vendosur në specifikime e ngushton në sisteme vetëm të Windows. Pra sistemet paraprake si Windows 8, 7. Ky konstatim nuk është në përputhje me sqarimet e dhëna paraprake në lidhje me këtë çështje, sepse ashtu sikurse është sqaruar në ekspertizën dhe vendimin e Panelit Shqyrtues me numër 458/20 dhe 95-98/21 kërkesa për sistemin operativ duhet të përfshijë edhe sistemet tjera operative ekuivalent me kusht që të mundësojë komunikimin dhe bartjen e të dhënave në pajisje me sistemin operativ Windows 10. Në këtë formë AK sigurohet që pajisja me të cilën furnizohet i përmbush nevojat e institucionit dhe zgjerohet konkurrenca në këtë aktivitetet të prokurimit. Sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 - OE ankues pretendon po ashtu se kërkesa për IP 68 për kontrollerin është kërkesë e lartë dhe si e tillë është diskriminuese pasi që nuk mund të plotësohet nga me shumë se një prodhues dhe është në kundërshtim me kërkesën për IP të stacionit total.

Në bazë të kërkimeve të bëra në ueb faqet e prodhuesve të pajisjeve kontrollere që mbledhin të dhënat e matjeve, është evidente se disa nga prodhuesit dhe pajisjet e tyre (kontrollere) përmbushin kërkesën për standardin IP 68. Disa nga prodhuesit dhe kontrolleret që plotësojnë këtë standard apo kanë standard janë <https://geospatial.trimble.com>; <https://topcon.co.jp> dhe <https://leica-geosystems.com>. Megjithatë, ekzistojnë prodhues tjerë dhe produkte tjera të cilat nuk plotësojnë këtë nivel apo kanë nivel më të vogël (IP 67) sikurse janë <https://geomax-positioning.com> dhe <https://chcnav.com>.

Për me shumë, në lidhje me këtë specifikim ka mospërputhje në mes të nivelit të mbrojtjes të kërkuara për Kontrollerin dhe Stacionin Total. Për kontrollerin kërkohet IP 68 ndërsa për Stacionin Total IP66. Duke marrë parasysh faktin që pajisjet përdorën në kombinim për

matjet gjeodezike në të njëjtat kushte atmosferike është e paarsyeshme një kontrast i tillë i specifikimeve të nivelit të mbrojtjes (IP) për 2 pajisje që përdoren në të njëjtin teren. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar në këtë pikë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4 – OE ankues pretendon se AK ka vendosur kërkesa sikurse janë formatet DWG, CSV, txt dhe Shapefile format e sipas OE ankues këto kërkesa dalin përtej kërkesave të pajisjeve të kërkuara në këtë aktivitetet të prokurimit.

AK në dokumentin Paramasa-Furnizim me pajisje të instrumentit GPS, tek pozicioni 1, përkatësisht tek Softueri i Terrenit ndër të tjera ka vendosur kërkesat: *“Te këtë mundësi eksporti ne formatet DWG, CSV, ShapeFile, TXT”* dhe *“Te kete mundësi importi e formatet DWG, CSV, ShapeFile, TXT Te kete mundësi eksporti ne formatet DWG, CSV, ShapeFile, TXT ”*. Në rastet e mëparshme AK-së është arsyetuar se këto formate janë të nevojshme për shkak të përdorimit të softuerit CadastralMap dhe të gjitha matjet gjeodezike që pranoen nga terreni janë në formatet që AK ka precizuar tek kërkesat e softuerit në këtë aktivitet të prokurimit dhe se këto formate janë domosdoshmëri. OE ankues në ankesë në lidhje me këtë pikë thekson se përkundër që softuerët gjeodezik fushor nuk e kanë këtë kërkesë pjesë të datasheet-it (katalogut), e mundësojnë eksportin dhe importin e të dhënave në këtë format. Eksperti e potencon se AK ka të drejtë të vendos specifikime që bazohen në nevoja dhe në këtë kuptim AK duhet të sigurohet që formatet janë ato të cilat i nevojiten për matje megjithatë nuk mund të vendos formate tjera të cilat nuk hyjnë drejtpërdrejtë në punë. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar në këtë pikë.

Sikurse është sqaruar mësipër në përgjigjet në pretendimet ankimore, specifikimet teknike dhe sqarimet e AK-së janë në kundërshtim me Nenin 7 dhe 28 të LPP-së, për shkakun se ashtu sikurse janë formuluar dhe sqaruar nga AK, reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të OE ose diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë OE, përkatësisht nuk janë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE dhe tenderuesit e interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Për me shumë sqarimi i AK-së se qëllimi i OE ankues është të ulen specifikimet në mënyrë që të sjellë produkte të prodhuesit CHC “prodhim kinez” dhe insititimi se “nuk do ti ulim specifikimet

teknike pasi që duam të marrim produkte që kanë histori dhe janë dëshmuar për cilësi" është joprofesional dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Kjo për faktin se qëllimi i një aktiviteti të prokurimit është blerja apo furnizimi me produktet që plotësojnë nevojat e AK-së duke i përkthyer nevojat në specifikimet teknike të domosdoshme për përmbushjen e funksioneve të AK-së, në këtë rast matjeve gjeodezike. Preferenca për brende të caktuara dhe injorimi i brendeve tjera nuk janë parime dhe përcaktime të cilat bazohen në rregullativën e prokurimit dhe profesionalisht të qëndrueshme për të siguruar furnizime cilësore. Kërkesa (specifikime) profesionale për të siguruar kualitet dhe qëndrueshmëri si shembull mund të jetë garancia për pajisjet apo edhe kushti që pajisjet të jenë të reja, e që më këtë rast AK nuk ka kërkuar fare garanci për produktet që do ti blejë e as nuk precizon që pajisjet duhet të jenë të reja të papërpunuara në çfarëdo forme (manufacturer refurbished).

Si përfundim, AK duhet të obligohet të ndërmerr veprime korrigjuese, për përmirësimin e specifikimeve teknike duke i bazuar në nevoja profesionale për përmbushjen e punëve për çfarë është lënda e aktivitetit dhe ofertat e tregut njëkohësisht.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE-ve ankues të aprovohet si e bazuar, më tej rekomandohet që të obligohet AK që të bëjë korrigjimin e specifikimeve sipas sqarimeve të mësipërme dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 06.10.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues individual ankesat e OE ankues i klasifikon si të bazuara dhe e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimit, i cili është caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe propozimi i tij për panelin shqyrtues është që ankesa e OE-ve ankues të aprovohet si e bazuar, më tej rekomandohet që të

obligohet AK që të bëjë korrigjimin e specifikimeve sipas sqarimeve të mësipërme dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit sipas raportit të ekspertit shqyrtues dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Andaj, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës komerciale-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Z. Vedat POTERQOI



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Gjakovë

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.